



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

SHTRIM PLLAKASH DHE VESHJE MURESH

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

B2-III-21

Tiranë më, 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

| Emërtimi i kualifikimit | Shtrim pllakash dhe veshje muresh | | | Kodi |
|--|--|---------------|---|------------------|
| Kohëzgjatja | 900-1100 orë | Niveli | III në KSHK, referuar nivelit III të KEK | B2-III-21 |
| Qëllimi: | Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shtrim pllakash dhe veshje muresh”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar, si punëtor i kualifikuar, në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shtrimin dhe veshjen me pllaka në sektorin e ndërtimit. | | | |
| Kriteret e përgjithshme të pranimit: | <p>Në shkollat që ofrojnë kualifikimin profesional “Shtrim pllakash dhe veshje muresh” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK ; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. | | | |
| Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: | <p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin mësimor “Shtrim pllakash dhe veshje muresh”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli si punonjës i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në sipërmarrje ndërtimi ose tregtimi si specialist i kualifikuar në punime shtrimi/veshje me pllaka dhe materiale të tjera në vila, pallate, zyra, dyqane, qendra tregtare, shkolla, trotuaresh etj.; dhe mbas një përvoja të suksesshme pune të vetëpunësohet si sipërmarrës duke punësuar individë të tjerë në veprimtarinë ku ai është specializuar.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK (teknik/menaxher) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p> | | | |
| Data e validimit | <i>(kur të miratohet)</i> | | | |
| Data e miratimit | | | | |
| Variantet e mëparshme | B-II-02-11; B2-III-18 | | | |

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Njohuri të përgjithshme të skicimit në ndërtim

- Të përshkruajë vizatimet e ndërtimit të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë dykatësh;
- Të përshkruajë vizatimet e ndërtimit të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë me skelet monolit prej betoni të armuar;
- Të interpretojë fletët e vizatimeve konstruktive dhe shenjat konvencionale të përdorura;
- Të përshkruajë vizatime të planimetrisë së kateve;
- Të përshkruajë vizatime të prerjeve;
- Të përshkruajë vizatime të pamjeve;
- Të përshkruajë vizatime të planimetrisë së themeleve dhe prerjeve të tyre;
- Të përshkruajë vizatime të planit të strukturave të ndërkateve;
- Të përshkruajë detaje arkitektonike dhe konstruktive të një objekti të thjeshtë dykatësh;
- Të interpretojë skicat me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje të mjediseve të brendshme/jashtme që shtrohen dhe vishen me pllaka;
- Të lexojë skicat e instalimeve në objekt (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ftohje-ventilim, gaz etj.) dhe shenjat konvencionale të përdorura;
- Të lexojë skicat e rrjetit inxhinierik në rrugë dhe trotuare (elektrik, furnizim me ujë, kanalizim etj.) dhe shenjat konvencionale të përdorura.

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të listojë legjislacionin për punimet e ndërtimit;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të interpretojë një projekt të dhënë;
- Të përshkruajë mënyrën e përzgjedhjes së mjeteve dhe veglave të punës sipas proceseve të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të vendit të punës sipas procesit të punës që do të kryejë;
- Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit të punës me disiplinat e tjera për organizimin e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të grafikut të punimeve;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të materialeve sipas procesit të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të mjeteve dhe pajisjeve sipas procesit të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të burimeve njerëzore sipas procesit të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së mjeteve dhe veglave të punës;
- Të përshkruajë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të materialeve, mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese dhe makinerive në vendin e punës.

Materialet

- Të listojë materialet prej guri natyror që përdoren në veshjen e shtrimin e sipërfaqeve;
- Të listojë materialet qeramike që përdoren në veshjen e shtrimin e sipërfaqeve;
- Të listojë materialet drusore dhe nënproduktet e tyre që përdoren në veshjen e shtrimin e sipërfaqeve;
- Të listojë materialet prej PVC-je, vinili, mikroçimentosh, rezinash të ndryshme etj.;
- Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së llaçeve;
- Të listojë materialet kryesore hidroizoluese;
- Të listojë materialet kryesore termoizoluese;
- Të listojë materialet kryesore zëizoluese;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e shtrimit të dyshemeve në kuotat e katit nëntokë, përdhe dhe ndërkatit;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e shtresave të tarracës pa/me shtresë ajri dhe me kornizë/parapet;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e veshjes së mureve të brendshme e të jashtme, bazamakëve, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e rikonstruksionit të dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme;
- Të listojë materialet ngjitëse të llojeve të ndryshme për shtrim dhe veshje;

Mjetet, instrumentet dhe makineritë e punës

- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të shtrimit të dyshemeve në kuotat e katit nëntokë, përdhe dhe ndërkatit;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të shtresave të tarracës pa/me shtresë ajri dhe me kornizë/parapet;
- Të përshkruajë mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të veshjes së mureve të brendshme e të jashtme, bazamakëve, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të përshkruajë mjetet e punës, instrumentet matëse e niveluese për punime të shtrimit të dyshemeve, me pllaka mermeri, pllaka qeramike, guri, dru e materiale të tjera;
- Të përshkruajë mjetet e punës, instrumentet matëse e niveluese për ndërtimin e dyshemeve teknike e industriale;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të shtrimit me pllaka të rrugëve dhe trotuareve;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e shtresës niveluese të dyshemeve në kuotat e katit nëntokë, përdhe dhe ndërkatit;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e shtrimit me pllaka të rrugëve dhe trotuareve;

Parapërgatitja e vendit të punës

- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së vendit të punës;
- Të përshkruajë masat e marra për sigurimin e vendit të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit të punës me grupe të tjera të punës në vendin e punës apo në ndërtesë, në funksion të kryerjes së procesit të punës pa ndërprerje e pengesa;
- Të përshkruajë përzgjedhjen e bazës materiale sipas procesit të punës;

- Të listojë llojet e veglave, mjeteve dhe instrumenteve sipas proceseve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit teknik për gatishmërinë e veglave, mjeteve dhe instrumenteve për punë;
- Të rendisë hapat për kryerjen e sigurimit të ndriçimit të duhur dhe furnizimin me ujë;
- Të përshkruajë llojet e matjeve të nevojshme sipas procesit të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse;
- Të përshkruajë masat e marra për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit ku punon (orendive e sipërfaqeve të tjera ekzistuese);
- Të përshkruajë mënyrat e heqjes së shtresave ekzistues në sipërfaqe ku do punohet;
- Të dallojë llojet e instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.) që vendosen në muraturë dhe nënshtrësat e dyshemesë;

Nivelimi sipërfaqeve

- Të përshkruajë mënyrat e nivelimeve dhe rëndësinë e tyre;
- Të rendisë hapat për kontrollin me instrumente nivelues;
- Të rendisë llojet e materialit mbushës për nivelime të llojeve të ndryshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e shënimit të kuotave referuese përkatëse;
- Të rendisë hapat e realizimit të nivelimit sipas proceseve të punës.
- Të përshkruajë metodat e përgatitjes së materialeve mbushëse e niveluese;

Izolimi i sipërfaqeve

- Të përshkruajë pastrimin dhe përgatitjen e sipërfaqes përpara izolimit;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e izolimeve dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë hapat e punimeve të hidroizolimit dhe shtresave të tjera për dyshemenë në kuotën e katit nëntokë (parkim etj.) për nivele të ndryshme të ujërave nëntokësore;
- Të përshkruajë hapat e punimeve të hidroizolimit dhe shtresave të tjera për dyshemenë në kuotën e katit përdhe në rastin pa kat nëntokë;
- Të përshkruajë hapat e hidroizolimit të dyshemeve në mjediset sanitare, sipas materialeve që përdoren për to;
- Të përshkruajë hapat e punimeve termoizoluese, si dhe shtresat e tjera të dyshemesë së ndërkatëve dhe mureve;
- Të përshkruajë hapat e punimeve zëizoluese si dhe shtresat e tjera të dyshemesë së ndërkatëve dhe mureve;
- Të përshkruajë hapat e punimeve termoizoluese e hidroizoluese e si dhe të shtresave të tjera të tarracave;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së materialit të përdorur sipas vendit, kushteve teknike dhe qëllimit të izolimit;

Shttrim dyshemeje të tipeve të ndryshme dhe veshje muresh

- Të interpretojë llojet e dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe materialet përbërëse të tyre;
- Të interpretojë veshjen e mureve të ndryshme dhe materialet përbërëse të tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së materialeve ngjitëse për tipet e ndryshme të dyshemeve;
- Të listojë llojet aksesorëve të ndryshëm për çdo tip dyshemeje;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e shtrimit të sipërfaqeve me pllaka qeramike;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e shtrimit të sipërfaqeve me pllaka mermeri dhe

- granit;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e shtrimit të sipërfaqeve me parkete druri e laminate;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e shtrimit të dyshemeve teknike e industriale;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e shtrimit të sipërfaqeve me shtresa me ngjitje (vinil, linoleum e materiale të gomuara);
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e shtrimit të sipërfaqeve me mikroçimento e rezina të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikat e prerjeve dhe përpunimit të pllakave prej materiali të ndryshëm;
- Të përshkruajë përgatitjen e bojakëve të ndryshëm sipas llojit të pllakës;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit të sipërfaqeve pas përfundimit të shtrimit
- Të përshkruajë përzgjedhjen e llojit të pllakave sipas pozicioneve të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat e përgatitjes dhe vendosjes së plintusave;
- Të përshkruajë hapat e shtrimit të dyshemeve me materiale plastike të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat e veshjes me pllaka të mureve të mjediseve të brendshme;
- Të përshkruajë hapat e veshjes së bazamakëve të shkallëve, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të përshkruajë hapat e veshjes së mureve të brendshme me pllaka dekorative;
- Të përshkruajë hapat e veshjes së mureve të jashtme (fasadave) me materiale të ndryshme;
- Të listojë parregullsitë e sipërfaqeve të dyshemeve/mureve që kërkojnë punime shtesë përgatitore për shtrimin/veshjen e tyre me pllaka;
- Të listojë defektet dhe shkakun e dëmtimeve të shtresës dyshemesë e sipërfaqes veshëse me pllaka;
- Të përshkruajë hapat për rikonstrukcionin e dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme.

Punime shtrimi me pllaka të rrugëve dhe trotuareve

- Të përshkruajë kuotat referuese në shtrimin me pllaka të rrugëve e trotuareve;
- Të përshkruajë hapat e shtrimit të shtresave të rrugëve dhe trotuareve me pllaka;
- Të përshkruajë hapat e vendosjes së shtrojave të dyshemeve të urave, si dhe materialet që përdoren për to.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të cilësisë së materialeve të shtrimit dhe veshjes me pllaka;
- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të cilësisë së përgatitjes së materialeve ngjitëse dhe mbushëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të cilësisë së aksesorëve të ndryshëm;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve të shtrimit të dyshemeve me pllaka e materiale të tjera sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve të veshjes së mureve të brendshme e të jashtme me pllaka e materiale të tjera sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve për rikonstrukcionin e dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme sipas specifikimeve

- teknike dhe skicës;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve për shtrimin e rrugëve dhe trotuareve me pllaka sipas specifikimeve teknike dhe skicës;

Njohuri për konstruksionet mbajtëse

- Të përshkruajë parimet bazë për konstruimin e elementet prej betoni të armuar që punojnë në përkulje (pllaka dhe trarë);
- Të përshkruajë parimet bazë për konstruimin e elementet prej betoni të armuar që punojnë në shtypje (shtylla dhe mure);
- Të përshkruajë parimet bazë për konstruimin e themeleve prej betoni të armuar (pllakë dhe trarë dhe plinta);
- Të përshkruajë parimet bazë për konstruimin e shkallëve prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura;
- Të përshkruajë llojet konstruksioneve mbajtëse prej guri e tulle, si dhe prej druri e metali.

Detyra administrative

- Të listojë llojet e dokumentacionit teknike që nevojitet për proceset e punës;
- Të përshkruajë mënyrën e përpilimit të një urdhër pune;
- Të listojë llojet e planeve afatshkurtra e më tej;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit;

Komunikimi

- Të dallojë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativës, korrektësisë, vetëkontrollit);
- Të argumentojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në grup në objekt ndërtimi;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të përshkruajë rëndësinë e raportimeve në mënyrë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë planin e sigurisë dhe koordinimit të objektit;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së higjienës personale në punë dhe kompletin e veshjes;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit për çdo lloj punimi të shtrimit dhe veshjes me pllaka.
- Të interpretojë situatat potenciale të rrezikshme, elementet që paraqesin rreziq individuale dhe kolektive profesionale;
- Të interpretojë mjetet, produktet, detyrat dhe zonat me rrezikshmëri, sipas rregullave të sigurimit teknik lidhur me rekomandimet specifike për sigurinë dhe shëndetin;
- Të përshkruajë kërkesat e rregulloreve të sigurimit teknik lidhur me instalimet elektrike, hidrosanitare, e ngrohje-ventilimit etj., si dhe në rastin e punimeve me makineri elektrike;
- Të përshkruajë rreziqet që lidhen me përdorimin e burimeve të ndryshme të energjisë (gaz, benzinë, ajër i presuar etj.);

- Të përshkruajë kushtet e montimit dhe qëndrueshmërisë të skelave që përdoren për të punuar në lartësi;
- Të interpretojë informacionin e dhënë në paketimin e materialeve që përdoren për çdo lloj punimi të shtrimit dhe veshjes me pllaka dhe materiale të tjera;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;
- Të përshkruajë rregullat dhe materialet për MSHNZ;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të vendit të punës;

Sipërmarrje

- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj;
- Të shpjegojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të shpjegojë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit të fushës së ndërtimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërëse të tij;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes të vëllimeve të punimeve përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes të materialeve të punimeve përkatëse.
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të ofertës sipas tabelave të çmimeve për punimet përkatëse;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut për punimet përkatëse.
- Të shpjegojë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore;
- Të përshkruajë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje;
- Të përshkruajë mënyrën e dorëzimit të punimeve të klienti;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Njohuri të përgjithshme të skicimit në ndërtim

- Të emërtojë vizatimet e ndërtimit që përbëjnë fletët arkitektonike të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë dykatësh;
- Të emërtojë vizatimet e ndërtimit që përbëjnë fletët konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë me skelet monolit prej betoni të armuar;
- Të lexojë fletët e vizatimeve arkitektonike dhe shenjat konvencionale të përdorura;
- Të vizatojë planimetritë e kateve të ndërtesës sipas skicës së dhënë;
- Të vizatojë prerjet e ndërtesës sipas skicës së dhënë;
- Të vizatojë pamjet e ndërtesës sipas skicës së dhënë;
- Të vizatojë planimetrinë e themeleve të ndërtesës dhe prerjet e tyre sipas skicës së dhënë;
- Të vizatojë planin e strukturave të ndërkateve;

- Të vizatojë detaje arkitektonike dhe konstruktive të një objekti të thjeshtë dykatësh;
- Të kryejë me dorë të lirë skica në planimetri dhe prerje sipas projekt-zbatimit të mjediseve të brendshme/jashtme që shtrohen dhe vishen me pllaka dhe materiale të tjera;
- Të identifikojë skicat e instalimeve në objekt (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.) dhe shenjat konvencionale të përdorura;
- Të identifikojë skicat e rrjetit inxhinierik në rrugë dhe trotuare (elektrik, furnizim me ujë, kanalizim etj.) dhe shenjat konvencionale të përdorura.

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të zbatojë legjislacionin për punimet e ndërtimit;
- Të zbatojë një projekt të dhënë;
- Të hartojë grafikun e punimeve
- Të përzgjedhë mjetet, instrumentet dhe veglat e punës sipas proceseve të punës;
- Të organizojë vendin e punës sipas procesit të punës që do të kryejë;
- Të koordinojë punën me disiplinat e tjera për organizimin e punës;
- Të zbatojë grafikun të punimeve
- Të realizojë planifikimin e materialeve sipas procesit të punës;
- Të realizojë planifikimin e mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve sipas procesit të punës;
- Të planifikojë burimet njerëzore sipas aftësive dhe procesit të punës;
- Të mirëmbajë mjetet, instrumentet, mjedisin dhe veglat e punës;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike të vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale në punë;
- Të sistemojë materialet, mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese dhe makineritë në vendin e punës;

Materialet

- Të përzgjedhë materialet prej guri natyror që përdoren në veshjen e shtrimin e sipërfaqeve;
- Të përzgjedhë materialet qeramike që përdoren në veshjen e shtrimin e sipërfaqeve;
- Të përzgjedhë materialet drusore dhe nënproduktet e tyre që përdoren në veshjen e shtrimin e sipërfaqeve;
- Të përzgjedhë materialet prej PVC-je, vinili, mikroçimentosh, rezinash të ndryshme etj.;
- Të përgatisë llaçin sipas procesit të punës dhe recepturës së dhënë;
- Të përzgjedhë materialet kryesore hidroizoluese sipas procesit të punës;
- Të përzgjedhë materialet kryesore termoizoluese sipas procesit të punës;
- Të përzgjedhë materialet kryesore zëizoluese sipas procesit të punës;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e shtrimit të dyshemeve e plintusave në kuotat e katit nëntokë, përdhe dhe ndërkatit;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e veshjes së mureve të brendshme e të jashtme, bazamakëve, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e rikonstruksionit të dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme;
- Të përzgjedhë materialet ngjitëse të llojeve të ndryshme për shtrim dhe veshje sipas

procesit të punës;

- Të zbatojë recepturat e materialeve lidhëse dhe t'i përgatisë ato sipas përdorimeve të tyre në punimet e shtrimit dhe veshjes me pllaka;

Mjetet, instrumentet dhe makineritë e punës

- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të shtrimit të dyshemeve e plintusave në kuotat e katit nëntokë, përdhe dhe ndërkatit;
- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të shtresave të tarracës pa/me shtresë ajri dhe me kornizë/parapet;
- Të përzgjedhë mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të veshjes së mureve të brendshme e të jashtme, bazamakëve, davancaleve, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të përzgjedhë mjetet e punës, instrumentet matëse e niveluese për punime të veshjes e të shtrimit të dyshemeve e mureve të brendshme e të jashtme, me mermer, pllaka qeramike, gur, dru e materiale të tjera;
- Të përzgjedhë mjetet e punës për shtrimin e parketeve, dyshemeve me dru e dyshemeve teknike;
- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe instrumentet matëse-niveluese për teknikat e punimeve të shtrimit me pllaka të rrugëve dhe trotuareve;
- Të përzgjedhë llojet e makinerive që përdoren për punimet e shtresës niveluese të dyshemeve në kuotat e katit nëntokë, përdhe dhe ndërkatit;
- Të përzgjedhë llojet e makinerive që përdoren për punimet e shtrimit me pllaka të rrugëve dhe trotuareve;

Parapërgatitja e vendit të punës

- Të kryejë parapërgatitjen e vendit të punës;
- Të marrë masat e duhura për sigurimin e vendit të punës;
- Të realizojë koordinimin e punës me grupe të tjera të punës në sheshin e punës apo në ndërtesë në funksion të kryerjes së procesit të punës pa ndërprerje e pengesa;
- Të përzgjedhë bazën materiale p;
- Të përcaktojë llojet e veglave, mjeteve dhe instrumenteve sipas proceseve të punës;
- Të realizojë kontrollin teknik për gatishmërinë e veglave, mjeteve dhe instrumenteve për punë;
- Të realizojë sigurimin e ndriçimit të duhur dhe furnizimin me ujë;
- Të kryejë matjet e nevojshme sipas procesit të punës;
- Të përdorë pajisjet dhe materialet sipas skedave dhe manualeve të pajisjeve të ndryshme.
- Të marrë masat për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit ku punon (orendive e sipërfaqeve të tjera ekzistuese);
- Të zbatojë mënyrat e duhura për heqjen e shtresave ekzistues në sipërfaqe;
- Të identifikojë llojet e instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.) që vendosen në muraturë dhe nënshtresat e dyshemesë;

Nivelimi sipërfaqeve

- Të kontrollojë sipërfaqet me instrumente matës dhe nivelues në dyshemenë/murin që shtrohet/vishet me pllaka dhe materiale të tjera;

- Të shënojë kuotat (pikat referuese) në dyshtemenë/murin që shtrohet/vishet me pllaka dhe materiale të tjera;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve të ndryshme mbushës për nivelime sipërfaqesh;
- Të përgatisë llojet e materialeve të ndryshme mbushës për nivelime sipërfaqesh sipas proceseve të punës;
- Të zbatojë hapat e nivelimit sipas proceseve të punës duke kontrolluar sipërfaqet me instrumente matës dhe nivelues në dyshtemenë/murin që shtrohet/vishet me pllaka dhe materiale të tjera;

Izolimi i sipërfaqeve

- Të kryejë pastrimin dhe përgatitjen e sipërfaqes përpara izolimit;
- Të zbatojë teknikat e izolimeve dhe rëndësinë e tyre;
- Të realizojë punimet e hidroizolimit dhe shtresave të tjera për dyshtemenë në kuotën e katit nëntokë (parkim etj.) për nivele të ndryshme të ujërave nëntokësore;
- Të realizojë punimet e hidroizolimit dhe shtresave të tjera për dyshtemenë në kuotën e katit përdhe në rastin pa kat nëntokë;
- Të realizojë hapat e hidroizolimit të dyshtemeve në mjediset sanitare sipas materialeve që përdoren për to;
- Të realizojë punime termoizoluese, si dhe shtresat e tjera të dyshtemesë së ndërkateve dhe mureve;
- Të realizojë punime zëizoluese si dhe shtresat e tjera të dyshtemesë së ndërkateve dhe mureve;
- Të realizojë punime termoizoluese e hidroizoluese e si dhe të shtresave të tjera të tarracave;
- Të përzgjedhë materialin e duhur sipas vendit, kushteve teknike dhe qëllimit të izolimit;

Shttrim dyshtemeje të tipeve të ndryshme dhe veshjen e mureve

- Të lexojë skicën dhe specifikimet për çdo punim të shtrimit të dyshtemeve dhe veshjes së mureve me pllaka dhe materiale të tjera;
- Të kryejë matje në vend dhe raportojë ndonjë mospërputhje me skicën përkatëse;
- Të përgatisë materiale ngjitëse për tipet e ndryshme të dyshtemeve;
- Të përzgjedhë llojet aksesorëve të ndryshëm për çdo tip dyshtemeje;
- Të kontrollojë dimensionet e pllakave me dimensionet standarde të paketimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojin e pllakave sipas pozicioneve, materialeve dhe sipërfaqeve të ndryshme sipas procesit të punës;
- Të zbatojë teknikat e prerjeve dhe përpunimit të pllakave prej materiali të ndryshëm;
- Të përgatisë bojakë të ndryshëm sipas llojit të pllakave;
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshtemeve e veshjes mureve me pllaka qeramike;
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshtemeve e veshjen mureve me pllaka mermeri dhe granit;
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshtemeve me parkete druri, laminate e vinili;
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshtemeve teknike e industriale;
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshtemeve e veshjes mureve me shtresa me ngjitje (vinil, linoleum e materiale të gomuar);
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshtemeve me mikroçimento e rezina të ndryshme;

- Të realizojë hapat e shtrimit të dyshemeve me materiale plastike të ndryshme;
- Të realizojë hapat e veshjes së bazamakëve të shkallëve, davancave, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të zbatojë hapat e duhura për veshjen e mureve të jashtme (fasadave) me materiale të ndryshme;
- Të kryejë punimet për veshjen e mureve të brendshme dekorative;
- Të kryejë punime për vendosjen e plintusave;
- Të pastrojë sipërfaqet pas përfundimit të shtrimit dyshemesë dhe veshjes mureve;
- Të konstatojë parregullsitë e sipërfaqeve të dyshemeve/mureve që kërkojnë punime shtesë përgatitore për shtrimin/veshjen e tyre me pllaka;
- Të dallojë defektet dhe shkakun e dëmtimeve të shtresës veshëse me pllaka;
- Të realizojë hapat për rikonstrukcionin e dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme;
- Të kryejë riparime të mundshme;

Punime shtrimi me pllaka të rrugëve dhe trotuareve

- Të shënojë kuotat referuese në shtrimin me pllaka të rrugëve e trotuareve;
- Të realizojë hapat e shtrimit të shtresave me pllaka të rrugëve dhe trotuareve;
- Të realizojë hapat e shtrimit me pllaka të dyshemeve të urave

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të garantojë cilësinë e materialeve të shtrimit dhe veshjes me pllaka;
- Të garantojë cilësinë e përgatitjes së materialeve ngjithëse dhe mbushëse;
- Të kontrollojë cilësinë e parapërgatitjes dhe vendosjes aksesorëve të ndryshëm;
- Të kontrollojë cilësinë së punimeve të shtrimit të dyshemeve me pllaka e materiale të tjera sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kontrollojë cilësinë së punimeve të veshjes së mureve të brendshme e të jashtme me pllaka e materiale të tjera sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kontrollojë cilësinë së punimeve për rikonstrukcionin e dyshemeve dhe veshjeve të mureve të brendshme e të jashtme sipas specifikimeve teknike dhe skicës;
- Të kontrollojë cilësinë së punimeve për shtrimin e rrugëve dhe trotuareve me pllaka sipas specifikimeve teknike dhe skicës;

Kkonstrukcionet mbajtëse

- Të zbatojë parimet bazë për konstruimin e elementet prej betoni të armuar që punojnë në përkulje (pllaka dhe trarë);
- Të zbatojë parimet bazë për konstruimin e elementet prej betoni të armuar që punojnë në shtypje (shtylla dhe mure);
- Të zbatojë parimet bazë për konstruimin e themeleve prej betoni të armuar (pllakë dhe trarë dhe plinta);
- Të zbatojë parimet bazë për konstruimin e shkallëve prej betoni të armuar;
- Të identifikojë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstrukcioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura;
- Të dallojë llojet konstrukcioneve mbajtëse prej guri e tulle, si dhe prej druri e metali.

Detyra administrative

- Të përcaktojë dokumentacionin e duhur teknik që nevojitet për procesin e radhës;

- Të hartojë urdhrat e punës;
- Të hartojë planet afatshkurtra e më tej;
- Të ruajë dhe arkivojë dokumentacionin;

Komunikimi

- Të zbatojë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativa, korrektësia, vetëkontrolli);
- Të punojë në grup / ekip duke bashkëpunuar me sektorët e tjerë;
- Të diskutojë në mënyrë profesionale me kolegët dhe vartësit në vendin e punës;
- Të respektojë komunikimin sipas hierarkisë;
- Të raportojë te personat përgjegjës në kohën e duhur;
- Të zbatojë orarin e punës dhe detyrat sipas përshkrimit të vendit të punës;
- Të demonstrojë aftësi në përdorimin e TIK në komunikimin global (reklama, shitje, blerje etj.).

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë planin e sigurisë dhe koordinimit të objektit;
- Të respektojë rregullat e ruajtjes së higjienës personale në punë dhe kompletin e veshjes;
- Të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës sipas manualeve teknike përkatëse;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit për çdo lloj punimi të shtrimit dhe veshjes me pllaka.
- Të kontrollojë situatat potenciale të rrezikshme, elementet që paraqesin rreziqe individuale dhe kolektive profesionale;
- Të kontrollojë mjetet, produktet, detyrat dhe zonat me rrezikshmëri, sipas rregullave të sigurimit teknik lidhur me rekomandimet specifike për sigurinë dhe shëndetin;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik lidhur me instalimet elektrike, hidrosanitare, e ngrohje-ventilimit etj., si dhe në rastin e punimeve me makineri elektrike;
- Të marrë masa paraprake për rreziqet që lidhen me përdorimin e burimeve të ndryshme të energjisë (gaz, benzinë, ajër i presuar etj.);
- Të zbatojë kushtet e montimit dhe qëndrueshmërisë të skelave që përdoren për të punuar në lartësi;
- Të konstatojë informacionin e dhënë në paketimin e materialeve që përdoren për çdo lloj punimi të shtrimit dhe veshjes me pllaka dhe materiale të tjera;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;
- Të zbatojë rregullat dhe materialet për MSHNZ;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në rastin e punimeve me makineri elektrike;
- Të marrë pjesë në montimin dhe çmontimin e skelave për punimet e veshjes së mureve, sipas kushteve teknike;

Sipërmarrje

- Të hartojë një plan të thjeshtë biznesi;
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti dhe menaxhimit të një buxheti të caktuar;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive

- të karrierës;
- Të përzgjedhë institucionet e duhura financiare që i nevojiten në biznesin e tij;
- Të bashkëpunojë me bankat duke përfituar nga shërbimet e tyre;
- Të zbatojë legjislacionin e punës dhe etikës së biznesit;
- Të përllogarisë vëllimet e punimeve për çdo proces pune;
- Të përllogarisë materialet e nevojshme për punimet përkatëse.
- Të hartojë ofertën sipas tabelave të çmimeve për punimet përkatëse;
- Të përdorë teknikat e marketingut për punimet përkatëse.
- Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.